



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr. 74 Datë 15.10.2007

PËR

NDRYSHIM STRUKTURE DHE DESTINACIONI TË PËRDORIMIT
TË FONDEVE PËR PAGA DHE SIGURIME SHOQËRORE PËR
KLUBIN SHUMËSPORTËSH "SKËNDERBEU"

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës, « NDRYSHIM STRUKTURE DHE DESTINACIONI TË PËRDORIMIT TË FONDEVE PËR PAGA DHE SIGURIME SHOQËRORE PËR KLUBIN SHUMËSPORTËSH "SKËNDERBEU", bazuar në ligjin nr 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh", ligjin nr 8399 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal", Ligjin nr 9645 dt. 27.11.2006 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007", Udhëzimin nr 2 dt. 17.01.2007 i M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007", Udhëzimin nr 353 dt. 19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007", si dhe V.K.B. nr. 2 dt. 02.02.2007 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007", V.K.B. nr. 3 dt 02.02.2007 "Për miratimin e strukturës së Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë ndryshimin e strukturës së Klubit Shumësportësh "Skënderbeu", duke hequr nga struktura mjekun definitiv dhe duke e kaluar mjekun me honorar.
2. Paga e mjekut të jetë 17.000 lekë në muaj e cila do të përcaktohet edhe në kontratën që do të lidhet midis Klubit Shumësportësh dhe mjekut.
3. Efekti financiar prej 124.048 lek. që sjell ndryshimin në strukturën e Klubit Shumësportësh "Skënderbeu" do të përdoret: 72.045 lekë për pagesën e mjekut me honorar dhe 52.003 do të kalojë në zërin e shpenzimeve për udhëtim dieta të Klubit Shumësportësh "Skënderbeu" sipas kësaj strukture buxhetore:

Pakësohet 00 08140 05 Art 6000000 - 102.802 lekë

Pakësohet	00	08140 05	Art 6010000	- 21.246 lekë
Shtohet	00	08140 05	Art 6024100	+ 52.003 lekë
Shtohet	00	08140 05	Art 6029005	+ 72.045 lekë

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës në Bashki dhe Klubi Shumësportësh "Skënderbeu".

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda NASE
Raimonda NASE

Dixhitalizuar nga Qendra ÇKP
www.infocip.org